



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PRESIDENTI**

**V E N D I M**

**Nr. 403, datë 25.11.2019**

**“PËR CAKTIMIN E DATËS PËR ORGANIZIMIN E PROCEDURËS PËR HEDHJEN E  
SHORTIT PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË EMËRIMEVE  
NË DREJTËSI NGA PRESIDENTI I REPUBLIKËS”**

Në mbështetje të nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe të nenit 221 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemin të drejtësisë”, të ndryshuar,

**VENDOSA:**

**Neni 1**

Hedhja e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të realizohet ditën e enjte, datë **5 dhjetor 2019, ora 12.00**, në sallën “Skënderbej”, në selinë e Presidentit të Republikës, me adresë Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 1 Tiranë.

**Neni 2**

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Presidentit të Republikës për publikimin e datës dhe orës së hedhjes së shortit në faqen zyrtare të Institucionit të Presidentit të Republikës dhe dërgimin e njoftimeve në adresë të institucioneve përkatëse, për të qenë të pranishëm gjatë zhvillimit të hedhjes së shortit.

**Neni 3**

Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Presidentit të Republikës për ngritjen e Sekretariatit Teknik për organizimin e procedurës për përzgjedhjen me short të anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, si dhe ndjekjen e procedurave të përcaktuara në Rregulloren “Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**

**ILIR META**

